

**AKT THEMELIMI DHE STATUT**  
**I**  
**SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

**InfinityAlpha Management SHPK**

**Sot me daten 19/04/2023 (dymije e njezet e tre)** ne Tirane, Shqiperi, jane prezent:

Zt. Igli Hoxha, djali i Eminit dhe Fatimes, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 24/09/1967, me numer Karte Identiteti 035280033 dhe numer personal G70924086L, banues ne Rruga Islam Alla, Pallati Edri, Sh 1, Ap 11, Tirane.

I cili vepron ne cilesine e themeluesit te vetem ligjor te Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar,  
me zotesi te plote per te vepruar dhe kuptuar,  
I cili kerkon themelimin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, ne perputhje me ligjin shqiptar dhe miraton sot dispozitat e ketij statuti dhe Akti Themelimi te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.

**Neni 1**

**Themelimi i Shoqerise**

Sot ne daten 19/04/2023, Une Themeluesi, themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar , te quajtur **InfinityAlpha Management SHPK** (qe ketej e me tutje te quajtur “Shoqeria”).

**Neni 2**

**Emertimi i Shoqerise**

1.1 Shoqeria e emertuar **InfinityAlpha Management SHPK**, eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e themeluar dhe qe ekziston ne perputhje me legjislacionin e Republikes se Shqiperise.

1.2 Shoqeria eshte themeluar sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “ Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” i ndryshuar dhe fiton personalitet juridik pas rregjistrimit te saj ne Rregjistrin Tregtar Shqiptar te mbajtur prane Qendres Kombetare te Bisnesit (QKB).

1.3 Shoqeria e zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe kete Statut.

**Neni 3**



## **Selia**

- 2.1 Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen : Rruga Pjeter Bogdani, Nd 10, H5, Ap 28, kati 7, 1019, Tirane Shqiperi.
- 2.2 Shoqeria mund te hape zyra perfaqesimi, dege dhe/ose filiale dhe/ose te marre pjese ne Shoqeri te tjera, te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me vendimet e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, qe mund te miratohen here pas here.

## **Neni 4**

### **Kohezgjatja**

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar te mbajtur prane QKB.

## **Neni 5**

### **Objekti**

Objekti i aktivitetit te Shoqerise do te jete: Agjent Investime dhe Ndermjetesime financiare, si dhe cdo lloj tjetër aktiviteti te lejuar dhe ne perputhje me ligjin shqiptar.

## **Neni 6**

### **Kapitali**

- 6.1 Kapitali i nenshkruar dhe teresisht i shlyer eshte 1,000 Leke.
- 6.2 Kapitali fillestar do te jete i ndare ne 1 kuote, me vlere te barabarte nominale prej 1000 leke per kuote. Kapitali i nenshkruar dhe i shlyer teresisht eshte i ndare ne perputhje me kontributin e themeluesve si me poshte vijon:

- Themeluesi Zt. Igli Hoxha, djali i Eminut dhe Fatimes, shtetas shqiptar, lindur ne Tirane, me 24/09/1967, me numer Karte Identiteti 035280033 dhe numer personal G70924086L, banues ne Rruga Islam Alla, Pallati Edri, Sh 1, Ap 11, Tirane.

*zoterues i 1 kuote, te cilat perfaqesojne 100% te kapitalit te Shoqerise.*

Pergjegjesia e Ortakut shtrihet deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin e Shoqerise.

- 6.3 Rritja apo zvogelimi i kapitalit fillestar behet vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe vetem ne perputhje me ligjet ne fuqi.

## **Neni 7**



## Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

- 7.1 Administratori(et), sipas gjykimit te tyre te lire ose me kerkesen Ortakeve, dhe/ose eksperti kontabel i miratuar, dhe/ose likujduesit (nese ka) mund te therrasin mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, por te pakten nje here ne vit. Ortakeve ju dergohet nje njoftim me shkrim per mbledhjen me ane te postes se rregjistruar apo postes elektronike, jo me pak se 7 dite perpare dates se mbledhjes, qe permban te dhenat per arsyen e mbledhjes, vendin, daten dhe oren e saj.
- 7.2 Verifikimi i njoftimit te mbledhjes nuk eshte i nevojshem nese te gjithe Ortaket jane te pranishem apo te perfaqesuar ne perputhje me kete nen.
- 7.3 Nese nuk parashikohet ndryshe nga ligji apo nga ky Statut, cdo veprim i cili ndermerret nga Asambleja e Ortakeve mund te merret pa mbledhje, pa njoftim ose pa votim, nese per kete veprim do te behet nje konsultim me shkrim i cili duhet te percaktoje veprimet e ndermarra dhe do te nenshkruhet nga te gjithe Ortaket e Shoqerise.
- 7.4 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve e thirrur rregullisht, perfaqeson te gjithe Ortaket e Shoqerise dhe eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te marre vendimet e meposhtme, por pa u kufizuar vetem ne to:
- (a) Percaktimin e politikave te biznesit;
  - (b) Emerimin dhe shkarkimin e Administratori(et)t(eve);
  - (c) Emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel dhe likujduesve;
  - (d) Rritjen dhe zvogelimin e kapitalit te Shoqerise;
  - (e) Miratimin dhe zbatimin e pasqyrave financiare per llogarite vjetore, te administrimit dhe te raporteve te mbikqyrjes;
  - (f) Miratimin e rregullave procedurale ne lidhje me mbledhjen e Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
  - (g) Miratimin dhe shperndarjen e fitimit vjetor;
  - (h) Miratimin e skemes se kompesimit per Administratori(et)n(et), likujduesin (it) dhe ekspertet kontabel;
  - (i) Ristrukturimin, prishjen, transformimin, bashkimin, likujdimin e Shoqerise ose riorganizimin e Shoqerise ne ndonje forme tjeter;
  - (j) Marrja e te gjitha masave me qellim qe Shoqeria te kete kapital dhe asetete te mjaftueshme per ushtrimin e aktivitetit dhe permbushjen e detyrimeve kundrejt te treteve;
  - (k) Te hipotekoje, lere peng dhe vendose barre mbi asetete e veta dhe te lidhe cdo marreveshje financiare me cdo pale financuese, me kusht qe hipoteka, peng apo barra tjeter, po ashtu si dhe marreveshjet perkatese financiare, te sherbejne per permbushjen e detyrimeve;
  - (l) Krijimin, mbylljen dhe/ose prishjen e degeve, zyrave te perfaqesimit dhe filialeve;
  - (m) Investime me vlere mbi 10,000 Euro;



- (m) Investime me vlere mbi 10,000 Euro;
- (n) Transferimin e asetëve të Shoqërisë;
- (o) Cdo çështje tjetër që përcaktohet nga ligji i zbatueshëm apo nga ky Statut.

## Neni 8

### Administrimi i Shoqërisë

8.1 Shoqëria do të administrohet nga 1 Administrator,

Zt. Igli Hoxha, djali i Eminit dhe Fatimes, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, me 24/09/1967, me numër Kartë Identiteti 035280033 dhe numër personal G70924086L, banues në Rrugë Islam Alla, Pallati Edri, Sh 1, Ap 11, Tiranë.

8.2 Administratori, emërohet për një periudhë kohore 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Administratori mund të shkarkohet përpara përfundimit të mandatit me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve.

8.3 Administratori(et) do të jetë përgjegjës për administrimin frytdhënës, të dobishëm e të kujdesshëm të Shoqërisë dhe do të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt paleve të treta në lidhje dhe në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe/ose të ligjit/eve të zbatueshëm. Administratori(et) ka kompetencë të plotë për administrimin e zakonshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe për administrimin e jashtëzakonshëm të Shoqërisë, të cilat do të përcaktohen me vendim të Ortakëve, përveç atyre kompetencave të cilat ushtrohen nga organe të tjera të Shoqërisë sipas këtij Statuti ose ligjeve të zbatueshme.

8.4 Administratori(et) do të ketë kompetencat dhe detyrat që lidhen me administrimin dhe mbikqyrjen e aktivitetit të Shoqërisë, si më poshtë vijon:

- (a) të mbikqyrë dhe zbatojë politikën dhe veprimtaritë tregtare të Shoqërisë dhe vendimet e Asamblesë së Ortakëve;
- (b) me kërkesë së Asamblesë së Ortakëve, të ndermarre masa të cilat janë kompetencë e kësaj të fundit, të propozojë vendimet që do të miratohen nga Asambleja e Ortakëve dhe të zbatojë këto vendime;
- (c) të sigurojë që Shoqëria respekton ligjin(et) e zbatueshëm dhe standartet kontabel;
- (d) të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar të Shoqërisë;
- (e) të përfaqësojë Shoqërinë kundrejt paleve të treta;
- (f) të sigurojë që dokumentat dhe librat kontabel të Shoqërisë të mbahen në rregull dhe me saktësi;
- (g) të thërrasi mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme kur e vlerëson të nevojshëm për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë;



- (i) te kryeje te gjitha rregjistrimet dhe publikimet e detyrueshem ne lidhje me Shoqerine, sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem;
- (j) ti raportoje Asamblese se Ortakeve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe aktivitetet e Shoqerise;
- (k) te miratoje hapjen e cdo procedure ligjore ose mbylljen e tyre.

8.5 Administratori(et) mund te ushtroje te gjitha kompetencat e Shoqerise si dhe te kryeje te gjitha veprimet qe me ligj ose per arsye te tjera nuk jane kompetence e Asamblese se Pergjithshme, ose nuk kufizohen nga ky Statut.

8.6 Administratori(et) eshte pergjegjes kundrejt Shoqerise dhe/ose paleve te treta per demet e shkaktuara nga shkelja e dispozitave te ketij Statuti ose te ligjeve te zbatueshme.

## **Neni 9**

### **Njoftimet**

Sa here kerkohet dhenia e nje njoftimi kundrejt cdonjerit prej perfaqesuesve te Ortakeve dhe Administratori(et)t ose anasjelltas, ky njoftim mund ti jepet personalisht ose duke derguar nje kopje me poste te rregjistruar, faks ose e-mail, ne adresen e tij qe rezulton ne librat e Shoqerise, ose qe ai vete i ka dhene Shoqerise per qellime njoftimi. Nese njoftimi dergohet me poste te rregjistruar apo faks, do te konsiderohet se i eshte dhene personit perkates 5(pese) dite pasi njoftimi eshte depozituar ne zyrat postare ose nga transmetimi i faksit apo sherbimi tek adresa e personit. Ky njoftim do te percatoje subjektin e njoftimit, sipas rastit.

## **Neni 10**

### **Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar**

Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar do te emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne rastet kur parashikohet ne legjislacionin shqiptar. Riemerimi i Ekpertit(ve) Kontabel te Autorizuar do te behet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi. Ekperti(et) Kontabel te Autorizuar mund te shkarkohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve ne rast shkeljeje te detyrave, gabimeve dhe sjellje jo te mire profesionale.

## **Neni 11**

### **Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te cdo viti kalendarik, Perjashtimisht viti i pare ushtrimor fillon ne daten e rregjistrimit te Shoqerise ne Rregjistrin Tregtar Shqiptar dhe perfundon ne 31 dhjetor 2023.

## **Neni 12**



### **Shperndarja dhe Prishja**

- 12.1 Shoqeria mund te shperndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Shperndarja e Shoqerise do te ndiqet nga prishja e saj.
- 12.2 Shoqeria do te ruaje personalitetin juridik, vetem per qellime qe lidhen me likujdimin dhe emertimi i Shoqerise gjate fazes se likujdimit do te ndiqet nga fjalet "ne process likujdimi".
- 12.3 Likujdatori(et) do te emerohen me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve. Prishja e Shoqerise dhe emerimi i Likujdatori(ve) do te kryhet ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

### **Neni 13**

#### **Ligji i Zbatueshem**

- 13.1 Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Statut dhe me dispozitat e ligjeve shqiptare te zbatueshme.
- 13.2 Ligji shqiptar per Shoqerite tregtare do te aplikohet per te gjitha aspektet te cilat nuk jane te rregulluara nga ky Statut.

Per cdo rast, aspekt apo ngjarje qe nuk parashikohet nga ky Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" i ndryshuar.

### **Neni 14**


#### **Mosmarreveshjet**

Cdo mosmarreveshje qe mund te linde ne lidhje me zbatimin ose interpretimin e ketij Statuti, si dhe cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe paleve te treta, do te zgjidhet nga gjykatat shqiptare kompetente.

### **Neni 15**

#### **Ndryshimet**

Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje Statut te ri me Vendim te Asamblese se Ortakeve.



Ky Statut i Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar Infinity Alpha Management Shpk, hartohet ne dy kopje ne gjuhen shqipe, qe do te kene te njejten vlere secila.

**ORTAKU I SHOQERISE**

IGLI HOXHA  
**Igli Hoxha**

A handwritten signature in blue ink, consisting of a series of loops and a long horizontal stroke extending to the right.